



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

RAPORTI* “INDEKSI KONSUMATORIT VENDOR”

Mars 2021

* “Ky botim u realizua nga Qendra “Konsumatorit Shqiptar” në kuadër të projekti “Indeksi i Konsumatorit Vendor”, me mbështetjen financiare të Leviz Albania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.


Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.”





PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Hyrje.....	5
II. Bashkitë dhe zyrat për mbrojtjen e konsumatorëve.....	7
III. Eksperiencat e bashkive me zyrat e mbrojtjes së konsumatorëve...12	
IV. Hapja e zyrave të mbrojtjes së konsumatorëve.....	21
V. Bashkitë dhe fushatat ndërgjegjësuese	27
VI. Indeksi i konsumatorit vendor	30
VII. Rekomandime	32






I. HYRJE

Qendra “Konsumatori Shqiptar” po zbaton që prej Prillit të vitit 2021, projektin “Indeksi i Konsumatorit Vendor”. Projekti mbështetet nga Lëviz Albania, i cili është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare, “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, “Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim” dhe “Co-Plan”.

Strategjia e Decentralizimi e Qeverisjes Vendore 2015-2020 dhe Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) rritën funksionet e bashkive, duke sjellë kështu më shumë shërbime për qytetarët e hapësira për mbrojtjen e konsumatorëve, duke synuar një qeverisje sa më pranë tyre. Kjo strategji ka parashikuar specifikisht se bashkitë duhet të kenë parasysh rregullat e mbrojtjes së konsumatorëve në miratimin e taksave e tarifave vendore kundrejt konsumatorëve. Nga ana tjetër, Ligji 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (i ndryshuar) dhe Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve e Mbikëqyrjen e Tregut 2014-2020 përcaktojnë se bashkitë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse duhet:

- të ngrenë Zyrat e Mbrojtjes së Konsumatorit (ZMK);
- të përmirësojnë ndërgjegjësimin qytetar në rolin e tyre si konsumator, si dhe
- edukimin e tij.

Pavarësisht kuadrit ligjor pothuajse të plotë, zbatimi i tij ka probleme në shumë drejtime. Përveç ngritjes së ZMK-ve, bashkitë ushtrojnë një sërë funksionesh, të cilat prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë konsumatorët dhe si e tillë çdo bashki duhet të ketë parashikuar në strukturën e saj



persona përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin se si këto funksione realizohen kundrejt qytetarëve.

Raporti Indeksi i Konsumatorit Vendor u realizua nëpërmjet marrjes së informacionit zyrtarë nga 61 bashkitë e vendit në lidhje me ekzistencën në bashki të ZMK-ve dhe konstatimin në terren të organizimit dhe funksionimit të tyre. Në kuadër të hartimit të këtij raporti iu kërkuar informacion 61 bashkive të vendit në lidhje me:

- Ngritjen e ZMK-së;
- Strukturën e organizimit të saj dhe detyrat që i janë ngarkuar;
- Fushatat ndërgjegjësuese/Sesionet Informuese të realizuara kundrejt qytetarëve për ngritjen e ZMK-së;
- Aktet nënligjore mbi të cilat është miratuar ngritja dhe funksionimi i ZMK-së.

Vjen për t'u përgëzuar fakti se $\frac{3}{4}$ e bashkive i janë përgjigjur kërkesës për informacion të Qendrës Konsumatori Shqiptar në mënyrë të shpejtë dhe duke paraqitur informacion të detajuar mbi ZMK. Ato bashkitë, të cilat nuk iu përgjigjën kërkesave të Qendrës u realizuan takime në terren me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, pjesë e komuniteteve të bashkive duke kërkuar ngritjen e ZMK. Nga ana tjetër u realizuan takime në terren me kryetarët bashkive duke iu parashtruar pse duhet të ekzistojnë ZMK-të dhe nevojën për ngritjen sa më parë të tyre.




II. BASHKITË DHE ZYRAT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Qendra Konsumatori Shqiptar realizoi një korrespondencë me email dhe postë zyrtare me 61 bashkitë e vendit, duke kërkuar prej tyre një informacion të detajuar mbi:

- Ngritjen e ZMK;
- Strukturën e organizimit të saj dhe detyrat që i janë ngarkuar;
- Fushatat ndërgjegjësuese/Sesionet Informuese të realizuara kundrejt qytetarëve për ngritjen e ZMK-së;
- Aktet nënligjore mbi të cilat është miratuar ngritja dhe funksionimi i ZMK-së.

Si rezultat i informacionit të marrë u bë i mundur krijimi i 61 pasaportave për 61 bashkitë, që përmbajnë informacion të detajuar mbi ZMK-të e çdo bashkie në vend.


1. Bashkitë dhe faqet zyrtare



Nga monitorimi i kryer deri më Shkurt të vitit 2021 nga 61 bashki, 58 bashki kanë faqe zyrtare funksionale dhe 3 prej tyre nuk janë të aksesueshme nëpërmjet faqes zyrtare, por vetëm nëpërmjet rrjetit social

Facebook. Bashkitë që nuk kanë faqe funksionale duhet të marrin masa për fillimin e funksionimit të faqeve zyrtare sepse ekzistenca e një faqe zyrtare dhe pasqyrimi i të gjithë informacionit në të është një detyrim i përcaktuar nga ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Bashkitë dhe kërkesat për informacion




Qendra Konsumatori Shqiptar në kuadër të projektit i është drejtuar të 61 bashkive të vendit nëpërmjet:

- Postës zyrtare;
- Emailit zyrtar të bashkisë dhe Kryetarit të bashkisë;
- Emailit zyrtar të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.



Kërkesat zyrtare janë ndërthurur dhe me takime në terren me Kryetarët e bashkive për të kërkuar ngritjen e ZMK-ve dhe realizimin e fushatave ndërgjegjësuese në kuadër të të drejtave të konsumatorëve në nivel vendor.

3. Bashkitë që kanë ZMK sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi:

Nga informacioni i administruar, 46 bashki nuk kanë të ngritur ZMK-të sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi: ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (i ndryshuar). Vetëm 15 nga 61 bashki në vend kanë ngritur ZMK sipas legjislacionit të sipërpërmendur.



4. Bashkitë që nuk kanë ZMK-të sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.



Bashkitë që nuk kanë ZMK-të të ngritur sipas legjislacionit në fuqi ndahen në dy kategori:


- Bashkitë që nuk kanë ZMK-në dhe nuk kanë specialist të ngarkuar për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Bashkitë, ku veterinerit i janë ngarkuar dhe detyrat për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel vendor.

Ligji nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) ka të përcaktuar se në çdo bashki të vendit duhet të funksionojnë strukturat e veterinarisë. Nga informacioni që u administrua në 16 bashki të vendit detyrat për mbrojtjen e konsumatorëve ia kanë ngarkuar veterinerëve dhe jo një specialisti të ndryshëm nga ky i fundit. Këto bashki përfshijnë mbrojtjen e konsumatorëve në Drejtoritë e Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, përkatësisht ku në këtë drejtori përfshihen dhe veterinerët.



Ajo që vihet re, është se 30 bashki nga 61 deklarojnë se nuk kanë ngritur ZMK-të, nuk kanë persona të ngarkuar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe nuk kanë realizuar asnjë aktivitet në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve. Arsyet që bashkitë nuk kanë ZMK-të e ngritura janë të shumta, si:

- Mungesa e informacionit që në çdo bashki duhet të ketë ZMK-në.
- Interpretimi i gabuar i legjislacionit në fuqi, duke arritur në përfundimin se bashkitë nuk kanë kompetenca në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.
- Bindja se strukturat veterinare duhet të kryejnë dhe detyrat në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.
- Mungesa e fondeve në buxhetet e bashkive për të ngritur një strukturë për mbrojtjen e konsumatorëve.
- Mungesa e vullnetit dhe dëshirës për të ngritur ZMK-të dhe organizimit të aktiviteteve në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

Mungesa e ZMK-ve në 45% të bashkive të vendit është një problematikë që duhet të zgjidhet dhe bashkitë duhet të marrin masat për ngritjen e ZMK-ve, duke realizuar në këtë mënyrë të drejtat e konsumatorëve në nivel vendor dhe duke rritur standardet e shërbimeve për qytetarët dhe cilësinë e jetesës së tyre.



60% nga 30 bashkitë që nuk kanë të ngritur ZMK-në ndodhen në jug të Shqipërisë dhe bashkitë e tjera i përkasin qendrës dhe veriut të Shqipërisë.



III. EKSPERIENCAT E BASHKIVE ME ZYRAT E MBROJTJES SË KONSUMATORËVE


Nga informacioni i administruar, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare të bashkive, monitorimit të faqeve zyrtare të tyre dhe kontakteve direkt me to, u bë e mundur krijimi i pasaportave për 61 bashkitë e vendit dhe u pasqyruan të dhënat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e ZMK-ve. Në këtë kapitull janë pasqyruar disa nga eksperiencat e bashkive me ZMK-të e ngritura, duke filluar nga Bashkia Tiranë që e ka ZMK-në të ngritur që prej vitit 2011, për të vijuar me bashkitë Pogradec, Maliq, Vlorë etj. dhe bashkitë që kanë hapur ZMK-të në periudhën 2020-2021.

Diagramet e ZMK-ve në bashki paraqesin informacion mbi organizimin dhe funksionimin e ZMK-ve duke parashtruar numrin e punonjësve, detyrat që i janë ngarkuar, vitet e funksionimit, fushatat ndërgjegjësuese të realizuar, masat e marra, faqet zyrtare etj.


Diagramet e ZMK-ve janë realizuar për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Lezhë, Pogradec, Maliq, Prrenjas, Gjirokastrë, Kukës, Vlorë, Bulqizë, Tropojë, Dimal, Konispol, Mallakastër, Lushnje, Vau i Dejës. Bashkitë e sipërpërmendura janë bashkitë të cilat në vija të përgjithshme i kanë ZMK-të sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve dhe vetëqeverisjes vendore.



BASHKIA TIRANË



BASHKIA KAMËZ



BASHKIA LEZHË




BASHKIA MALIQ



BASHKIA POGRADEC



BASHKIA GJIROKASTËR



BASHKIA PRRENJAS




BASHKIA KUKËS



BASHKIA VLORË



BASHKIA BULQIZË



BASHKIA TROPOJË




BASHKIA DIMAL



BASHKIA KONISPOL



BASHKIA MALLAKASTËR



BASHKIA LUSHNJE



BASHKIA VAU I DEJËS



IV. HAPJA E ZYRAVE TË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

Një ndër rezultatet e pritshme të Indeksit Konsumatorit Vendor ishte hapja e të paktën e 1 ZMK-je në një nga bashkitë e vendit. Si rezultat i korrespondencës së ndjekur, ndërgjegjësimit dhe informacionit të vendosur në dispozicion të bashkive vjen për t'u përgëzuar fakti se tre bashki i janë përgjigjur pozitivisht Qendrës Konsumatori Shqiptar, që ka ndërmjetësuar përcjelljen e kërkesave të qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile të bashkive përkatëse, në kuadër të ngritjes së ZMK-ve. Bashkitë që kanë ngritur ZMK-të janë:

- Bashkia Peqin;
- Bashkia Rrogozhinë;
- Bashkia Kukës.

Qendra Konsumatori Shqiptar i është drejtuar shkresërisht bashkisë Vau Dejës për marrjen e informacionit në lidhje me ZMK-në. Nga verifikimet e kryera kemi konstatuar se Bashkia Vau Dejës ka hapur ZMK-në brenda 30 ditëve, nga kërkesa zyrtare për informacion të realizuar nga Qendra Konsumatori Shqiptar.

Bashkia Gramsh pas kontakteve të realizuar me Qendrën ka deklaruar se do të ngarkojë një specialist që do të merret me mbrojtjen e konsumatorëve. Më datë 21.03.2021 Kryetari i Bashkisë Gramsh nëpërmjet urdhrit nr. 94, datë 25.03.2021 ka miratuar detyrat e specialistit përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve*.


Bashkia Patos edhe pas qëndrimit skeptik në fillim të korrespondencës, në muajin Mars ka kërkuar nga Qendra informacion më të detajuar dhe ka deklaruar se do të bëjë të mundur hapjen e ZMK-së shumë shpejt. Bashkia Shkodër dhe Korçë edhe pse kanë pasur qëndrim skeptik për hapjen e ZMK-së, pas takimeve të realizuara dhe kronikave të transmetuara në media janë shprehur së do të fillojnë procedurat për hapjen e ZMK-së.

Të gjitha bashkive i janë vendosur në dispozicion të gjitha materialet e prodhuara nga Indeksi i Konsumatorit Vendor dhe fletëpalosjet që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në nivel vendor. Gjithashtu është kërkuar nga Qendra "Konsumatori Shqiptar" fillimi i punës sa më shpejt dhe realizimi i sa më shumë fushatave ndërgjegjësuese për informimin e qytetarëve për ekzistencën e ZMK-së dhe të drejtat që gëzojnë ata në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

* Aneksi nr.1 Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Gramsh nr.94, datë 21.03.2021.

IV.1 BASHKIA RROGOZHINË

Bazuar në kërkesën e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile në Bashkinë Rrogozhinë dhe duke u mbështetur tek rregulloret e hartuara nga projekti Bashki të Forta, për iniciativat qytetare, peticionet etj., Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit në Bashkinë Rrogozhinë është hapur si rezultat i kërkesës së komunitetit dhe biznesit. Bazuar në përcaktimet e sipërpërmendura kërkesa ju drejtua Këshillit Bashkiak, Rrogozhinë i cili bëri të mundur aksesimin e problematikës ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë. Vjen për t'u përgëzuar fakti që kjo bashki ka ngritur ZMK duke u nisur dhe nga fakti që buxheti i kësaj bashkie është i vogël dhe ka pasur dëme të konsiderueshme si rezultat i dy tërmeteve në vitin 2019.



Nr prot. 30

Drejtuar: *Znj. Mukades Gixhari*
Kryetare
Këshilli Bashkiak, Rrogozhinë

Date 19.10.2020

Lënda: *Kërkesë për hapjen e Zyrës hapjen e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve*

E nderuar znj. Kryetare,

Qendra "Konsumatori Shqiptar" po zbaton që prej muajit Prill të vitit 2020, projektin "Indeksi i Konsumatorit Vendor" i mbështetur nga Lëviz Albania, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare, "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-Plan". Ky projekt ka për qëllim të mbështesë zbatimin e politikave dhe legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit në nivel vendor për të arritur një cilësi më të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët. Ligji nr. 9902/2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" (i ndryshuar) dhe Strategjia Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve e Mbrojtjes dhe Ekonomisë, duhet të përcaktojnë se bashkitë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duhet të ngrënë Zyrat e Mbrojtjes së Konsumatorit (ZMK), të përmirësojnë ndërgjegjësimin qytetar në rolin e tyre si konsumator, t'i informojnë dhe edukojnë konsumatorët, si dhe të trajtojnë ankesat e tyre, drejtpërdrejt ose me delegim, duke i shërbyer qytetarit.

Qendra "Konsumatori Shqiptar" në kuadër të aktivitetit të saj, ka realizuar një monitorim në terren të kushteve të tregjeve, subjekteve tregtare dhe të informacionit që disponojnë tregtarët në Bashkinë Rrogozhinë në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Nga monitorimi në terren u vu re se tregtarët dhe vetë qytetarët e kanë shumë të nevojshme ngritjen e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve në bashki. Qendra parashtron kërkesën e saj kundrejt Këshillit Bashkiak, Rrogozhinë për të ndërmjetësuar në ngritjen e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Bashkinë Rrogozhinë duke marrë në konsideratë faktin se në këtë periudhë, Bashkia është në hartimin e projektbuxhetit për vitin 2021.

Qendra "Konsumatori Shqiptar" shpreh dëshirën për t'iu asistuar në procesin e ngritjes së Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe gjithashtu organizimin e fushatave ndërgjegjëse dhe informuese nga zyra në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

Sa më sipër, mbetemi në pritje të një përgjigje nga ana juaj.

Me respekt
Qendra Konsumatori Shqiptar
Drejtoresha Ekzekutive
Ersida Tefti

Ersida Tefti

Kontakt: 0693961511
Email: indeksikonsumatorivendor@gmail.com
Adresa: Qendra "Konsumatori Shqiptar", L.11, Rr. Kumini, Pall.1319, Durres, Albania

Bashkia Rrogozhinë iu përgjigj pozitivisht kërkesës së komunitetit dhe të Qendrës Konsumatori Shqiptar për hapjen e ZMK-së:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 706 Prot. Rrogozhinë, më 29/01/2021

URDHËR
"PËR PUNËSIM"

Nr. 55 Datë 29/01/2021

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2013 "Për rregullat e etikës në administratën publike", Vkm-në nr.165 dt 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, " Për grupimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, VKB-në Nr.4 datë 05.01.2021, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë" , konfirmuar me ligjshmërinë Nr.47/1 prot. datë 15.01.2021, edhe Vendimin Nr.23 datë 21.01.2021 "Për Miratimin e strukturës Organizative të Bashkisë Rrogozhinë për Vitin 2021", Vendimin Nr.5311 datë 06.12.2019 "Për miratimin e Rregullores Për Organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Rrogozhinë" ,

URDHËROJ:

1. Emwrimin e Z.Celik Kolgega me detyrën koordinator pranë "Zyrës së Mbrojtjes së Konsumatorit" në Bashkisë Rrogozhinë.
2. Paga e pozicionit IV-a.
3. Marrëdhëniet financiare i fillojnë më datë ___/___/2021.
4. Marrëdhënia e punës do të rregullohet sipas dispozitave të kodit të punës dhe kushteve të përcaktuara në kontratën individuale të punës.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Financës& Shërbimit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Edison MEMOLLA



Koordinatori për Mbrojtjen e Konsumatorit në Bashkinë Rrogozhinë ka raportuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 21.01.2021 në lidhje me problematikat e konstatuara në terren dhe masat që duhet të marrë Bashkia Rrogozhinë në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në nivel vendor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 2
Rrogozhinë , më 21.01.2021 ora 14 : 00 °°

Zhvillohet mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Bashkiak, e cila mbahet elektronikisht, online (nëpërmjet app ZOOM Cloud Meetings) për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, në zbatim të Urdhërit të Ministres së Shëndetësisë Nr.633, datë 17.11.2020 "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".



Rendi i ditës :

Çelik Kolgega. Ne kërkojmë mbështetjen e Këshillit Bashkiak në këtë drejtim pasi kjo është një gamë shumë e gjërë dhe me shumë hapësirë duke parë që Bashkia ka shumë resurse që nga bregdeti dhe deri tek majat më të larta siç është zona më e thellë . Edhe kjo kërkon jo vetëm anagazhimin tonë por do jetë e nevojshme për të kërkuar edhe ndihmën e Këshillit Bashkiak për ndihmë edhe nga ana e policisë edhe nga e drejtorive të tjera që funksionojnë në Bashki . Të bashkëpunojmë të gjithë me njëri tjetrin dhe mund ta realizojmë këtë gjë kërkojmë edhe mbështetjen... për momentin ne jemi pjesë e zyrës së veterinarisë dmth nuk kemi zyrë akoma as mjete dhe pajisje . Në lidhje me këtë ne kemi një takim brenda javës me qendrën në Tiranë dhe do marrim udhëzime akoma më të hollësishme dhe këto do t'i paraqesim përsëri drejtorive përkatëse të shërbimeve sociale është një gamë me shërbime me ndërtime me rrugë që kërkojnë që konsumatori nuk ka se ku të drejtohet dhe kjo besoj se do ti vijë në ndihmë të gjithë konsumatorëve të gjithë qytetarëve sado pak për t'i ndihmuar në jetën e tyre të përditshme. Ju faleminderit.

IV.2 BASHKIA KUKËS

Bashkia Kukës ka hapur ZMK-në në Dhjetor të vitit 2020 pas kërkesës së Qendrës “Konsumatori Shqiptar” për vendosjen në dispozicion të informacionit për organizimin dhe funksionimin e ZMK-së. ZMK-ja e bashkisë Kukës ka në përbërjen e saj dy persona, 1 përgjegjës sektori dhe 1 Inspektor dhe është pjesë përbërëse e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave.


Për sektorin janë miratuar përshkrimet e punës dhe pjesë e rregullores së Bashkisë Kukës janë bërë tashmë dhe detyrat për mbrojtjen e konsumatorëve. ZMK-ja ka filluar punën për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për qytetarët dhe po realizon monitorime në terren për të konstatuar problematikat dhe rekomanduar marrjen e masave nga Bashkia Kukës për realizimin e të drejtave të konsumatorëve në nivel vendor.



IV.3 BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin nga informacioni i administruar nuk kishte një ZMK të ngritur sipas legjislacionit në fuqi. Detyrat e mbrojtjes së konsumatorit realizoheshin nga specialistët e sektorit të veterinarisë në Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve.


Pas ndërjegjësimit dhe takimeve të realizuar me Bashkinë Peqin u bë e mundur hapja e ZMK-së për vitin 2021, ku një specialist u ngarkua me detyrat për mbrojtjen e konsumatorëve dhe nënkryetarja e bashkisë është ngarkuar në monitorimin e mbrojtjes së konsumatorëve për Bashkinë Peqin.




V. BASHKITË DHE FUSHATAT NDËRGJEGJËSUESE

Disa bashki kanë organizuar fushata ndërgjegjësuese për qytetarët dhe tregtarët në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve dhe ngritjes së ZMK-së në këto bashki.

Bashkia Patos iu bashkua kërkesës së Qendrës “Konsumatori Shqiptar” për të ndërgjegjësuar qytetarët mbi të drejtat e konsumatorëve në nivel vendor dhe realizoi në Ditën Ndërkombëtare të Konsumatorit, 15 Mars 2021, ndërgjegjësime mbi të drejtat e konsumatorëve në nivel vendor dhe mekanizmat që ekzistojnë në Bashkinë Patos për t’i realizuar ato.



Bashkia Peqin ka realizuar fushatë ndërgjegjësuese për të rinjtë e shkollave të mesme në Ditën Ndërkombëtare të Konsumatorëve, ku ka shpërndarë dhe materiale të realizuar nga Indeksi i Konsumatorit Vendor.




Bashkia Lushnje organizoi me datë 15 Mars 2021, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Konsumatorëve, në bashkëpunim me Qendrën "Konsumatori shqiptar" një fushatë ndërgjegjësuese dhe informuese me banorët e kësaj bashkie.





Bashkia Kamëz ka organizuar fushata ndërgjegjësuere me konsumatorët në kuadër të njohjes së të drejtave të tyre si konsumator në nivel vendor si me qytetarët dhe me tregtarët.



VI. INDEKSI I KONSUMATORIT VENDOR


Krijimi i 61 pasaportave për bashkitë në kuadër të organizimit dhe funksionimit të ZMK-ve bëri të mundur krijimin e Indeksi Konsumatori Vendor. Të 61 bashkitë e vendit u vlerësuan sipas një sistemi pikëzimi që bëri renditjen e tyre në bazë të nivelit më të mirë të organizimit dhe funksionimit të ZMK-ve për secilën bashki. Vlerësimi është kryer sipas sistemit të pikëzimit të mëposhtëm:

Indikator	Pikët	Vlerësimi i Bashkisë
Struktura	10	
Organizimi	10	
Buxheti	10	
Kompetenca	10	
Aktivitete të organizuara	10	

Në bazë të informacionit të grumbulluar nëpërmjet korrespondencës zyrtare, monitorimit të faqeve zyrtare të bashkive dhe takimeve në terren u bë i mundur vlerësimi i 61 bashkive të vendit dhe renditja e tyre në një sistem vlerësimi duke renditur të parën bashkinë “më mirë” të organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe në fund bashkitë, të cilat nuk kanë ende të ngritur ZMK-të.

Nga sistemi i vlerësimit u rendit në vend të parë me një strukturë më mirë të organizuar sipas legjislacionit në fuqi, Bashkia Tiranë. Gjithashtu është për t’u theksuar fakti se Bashkia Tiranë ka arritur në këtë nivel organizimi që ka sot edhe fal viteve të shumta që kjo strukturë ekziston dhe funksionon.

Bashkia Tiranë e ka ngritur ZMK-në që prej vitit 2011, prej më shumë se 10 vitesh dhe kjo e ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit në punë dhe shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve.



Indeksi i Konsumatorit Vendor

	Struktura	Organizimi	Buxheti	Kompetenca	Aktivite	Mesatarja
Bashkia Mallakastër, mesatarja 8.6	10	8	8	8	9	8.6
Bashkia Tiranë, mesatarja 8.6	10	8	8	7	10	8.6
Bashkia Dimal, mesatarja 7.4	8	8	7	7	7	7.4
Bashkia Vlorë, mesatarja 7.2	9	7	7	7	6	7.2
Bashkia Kamëz, mesatarja 7	8	8	8	5	6	7
Bashkia Lezhë, mesatarja 7	8	8	8	5	6	7
Bashkia Konispol, mesatarja 6.6	8	8	5	7	5	6.6
Bashkia Tropojë, mesatarja 6.4	6	6	5	8	7	6.4
Bashkia Vau i Dejës, mesatarja 6.2	7	7	5	7	5	6.2
Bashkia Bulqizë, mesatarja 6.2	6	6	5	7	7	6.2
Bashkia Maliq, mesatarja 5.4	6	6	6	4	5	5.4
Bashkia Pogradec, mesatarja 5	5	6	5	4	5	5
Bashkia Gjirokastrë, mesatarja 3.8	4	4	4	3	4	3.8
Bashkitë veterineri =ZMK, mesatarja 1.2	2	1	1	1	1	1.2
Bashkitë pa ZMK, mesatarja 0	0	0	0	0	0	0



VII. REKOMANDIME

Indeksi Konsumatori Vendor ka kaluar objektivat e vendosura në projekt, kjo falë edhe takimeve të shumta të realizuara me komunitete në bashki të ndryshme të vendit. Indeksi Konsumatori Vendor në kuadër të Raportit të tij arriti:

- Hapjen e 3 ZMK-ve, përkatësisht në bashkitë: Rrogozhinë, Kukës dhe Peqin dhe ka arritur sigurimin e hapjes së ZMK në muajt në vijim në tre bashki;
- Realizimi nga tre bashki, si: Patosi, Peqini, Lushnja dhe Kamza i fushatave ndërgjegjësuese për hapjen e ZMK-së dhe të drejtat e konsumatorëve në nivel vendor;
- Ndërgjegjësimi i komuniteteve në: Patos, Tiranë, Vorë, Librazhd, Lushnje, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kavajë, Dimal për organizimin dhe funksionimin e ZMK-së dhe të drejtat e konsumatorëve në nivel vendor;
- Ndërgjegjësimi i bashkive si: Cërrik, Gramsh, Divjakë, Berat për ngritjen e ZMK-së;
- Bashkitë si: Cërrik, Gramsh, Patos, Divjakë dhe Berat parashtruan hapjen e ZMK-së gjatë muajit Maj, sepse sipas legjislacionit në fuqi për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021 nuk lejohet ndryshimi i numrit të punonjësve të bashkive deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Megjithatë duke marrë në konsideratë informacionin e grumbulluar dhe takimet në terren të zhvilluara ka ende punë për t'u bërë nga bashkitë e vendit. "Indeksi Konsumatori Vendor" nisur na sa më sipër kishte për qëllim të mbështeste zbatimin e politikave dhe legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel vendor për të arritur një cilësi më të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët. Për të arritur qëllimin e sipërpërmendur dhe për të realizuar objektivin e saj për rritjen e



ndërgjegjësimit të qytetarëve në mënyrë, që të kenë kuptim të qartë të të drejtave që i përkasin si konsumatorë vendorë e të nxiten të reagojnë për të mbrojtur të drejtat e tyre, duhet që:

15 bashkitë që i kanë tashmë të ngritura ZMK-të sipas legjislacionit në fuqi duhet të:*


- Realizojnë sa më shumë fushata ndërgjegjësuese për qytetarët, ku të pasqyrojnë ekzistencën e tyre dhe të drejtat e konsumatorëve.
- Fokusohen në përcaktimet ligjore që ka legjislacioni në fuqi në nivel vendor duke mos tejkaluar kompetenca apo mbivendosur ato me kompetenca e pushtetit qendror.
- Rrisin bashkëpunimin me institucionet qendrore në mënyrë të tillë, që shërbimi i ofruar për qytetarët të jetë sipas standardeve të kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe në kohë të shpejtë dhe efikasitet, duke konstatuar menjëherë nëse ankesa/problematika i përket pushtetit qendror apo vendor.
- Rrisin bashkëpunimin me bashkitë e tjera të vendit, për të shkëmbyer eksperiencë ndërmjet bashkive dhe duke ndihmuar kështu bashkitë që nuk janë të fuqizuara në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve të mund të fuqizohen dhe të angazhohen kundrejt qytetarëve.

*16 bashkitë që i kanë ngarkuar detyrat e ZMK-ve veterinerëve duhet të**:*

- Marrin masa që detyrat në kuadër të ZMK-së t'i ngarkohen një specialisti, që punën e tij ta ketë të fokusuar tek mbrojtja e konsumatorëve, sektorët e veterinarisë në bashki funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi të veterinarisë dhe nuk mund të realizojnë edhe ato në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

* Bashkitë që kanë ZMK-të janë: Tiranë, Bulqizë, Lezhë, Përmet, Përrenjas, Kukës, Gjirokastër, Pogradec, Dimal, Kamzë, Maliq, Konispol, Devoll, Vlorë, Vau i Dejës.

** Këto bashki janë: Shkodër, Delvinë, Peqin, Kolonjë, Patos, Tropojë, Mallakastër, Klos, Fier, Rogozhinë, Lushnje, Belsh, Memaliaj, Poliçani, Mirditë, Malësi e Madhe.



- Marrin eksperiencat e mira të bashkive si Tirana, Lezha, Kamza, Pogradeci etj., dhe ti përvetësojnë ato. Kjo do ti shërbejë bashkive që të ngrenë struktura efikase dhe të mësojnë nga eksperiencat e bashkive që e kanë prej shumë vitesh ZMK-në apo dhe nga ato që e kanë hapur në kohët e fundit.


30 bashkitë që nuk kanë të ngritur ZMK-të duhet të:*

Fillojnë nga puna për programimin në buxhetet e tyre të fondeve për ngritjen e ZMK-së dhe kjo duhet të ndodh sa më shpejt. Legjislacioni në fuqi kërkon që prej me shumë se 5 vitesh, që bashkitë të kenë të ngritura ZMK-të dhe t'i ngarkojnë ato me detyrat në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

61 bashkitë e vendit duhet:

- Të fillojnë të marrin masa për programimin e fondeve për mbrojtjen e konsumatorëve, të nevojshme këto për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese, ngritjen e mekanizmave për mbrojtjen e konsumatorëve, trajnimin e stafeve të bashkive etj.
- Rritja e trajnimeve ndaj stafeve të bashkive në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve në nivel vendor.
- Të vendosin ura bashkëpunimin ndërmjet tyre në mënyrë të tillë që të ndajnë eksperiencat dhe praktikat e mira profesionale për mbrojtjen e konsumatorëve.
- Të rrisin monitorimet në terren për konstatimin e problematikave të qytetarëve dhe bizneseve në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve, për të pasur një panoramë të qartë të situatës dhe marrjen e masave të duhura në të mirë të qytetarëve/konsumatorëve.

* Këto bashki janë: Dibër, Pustec, Dropull, Shijak, Mat, Durrës, Roskovec, Himarë, Skrapar, Has, Sarandë, Korçë, Kuçovë, Divjakë, Cërrik, Gramsh, Selenicë, Fushë - Arrëz, Pukë, Kurbin, Tepelenë, Librazhd, Libohovë, Vorë, Berat, Krujë, Kavajë, Finiq, Këlcyrë, Elbasan.



7. kontribuon në përgatitjen e materialeve të ndryshme, që kanë lidhje me veprimtarinë e sektorit që përfaqëson dhe merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione dhe borde, me propozim të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratim paraprak të Kryetarit të Bashkisë;

8. është pjesë e grupit të punës së trajnimit, për të punësuarit apo rekrutimet e reja në sektorin që drejton;

9. ndjek në mënyrë të vazhdueshme respektimin e afateve në korrespondencën me konsumatorët apo institucionet të cilave sektori ju është drejtuar për kompetencë, si dhe është përgjegjës për mosrespektim të këtyre afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi

10. përgatit dhe miraton tek Drejtori i Drejtorisë, programin vjetor të punës së sektorit të tij për vitin kohor dhe programin për parashikimet në vitin pasardhës;

11. paraqet propozime pranë Drejtorit të Drejtorisë, për ndryshime apo rregullime në dispozitat ligjore, nënligjore e normative në fuqi, mbi të cilat ushtron kompetencat sektori përkatës dhe për mënyrën më efektive të organizimit e të funksionimit të sektorit.

V. Detyrat e specialistit

-Specialisti, ka varësi të drejtpërdrejtë nga përgjegjësi i zyrës dhe ka në objektivat e punës së tij, ndjekjen me përparësi dhe zgjidhjen profesionalisht të problematikave dhe detyrave të ngarkuara.

- Specialisti, ushtron kompetencat e mëposhtme:
 1. zbaton me përpikëri, nivel të lartë profesional dhe përkushtim, të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprori i tij;
 2. përgjigjet për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, me përparësi, duke respektuar rigorozitetin afatet e zgjidhjes;
 3. ndjek korrespondencën që i është drejtuar, duke respektuar afatet e përcaktuara dhe këshillohet me kolegët për zgjidhjen e problematikave që ka për detyrat e punës;
 4. përgatit materialin e kërkuar për sektorin ku bën pjesë;
 5. mban përgjegjësi personale për detyrat e punës;
 6. i nënshtrohet trajnimeve të publikë ose private, për t'i bërë më mirë të detyrës së ngarkuar dhe të lidhur me detyrën specifike të punës.

VI. Aktet administrative

- Sektorit i Shërbimit Veterinar, bashkisë Gramsh, në fuqi

Adnan Shahu "Kambar Detyrat"

funkionale, në zbatim të akteve nënligjore normative të Këshillit Bashkiak dhe/ose Kryetarit të Bashkisë, procedon me formularët e miratuar "Akti Konstatim" dhe "Proces Verbal mbi Kundërvajtjen Administrative", të cilat në formë dhe përmbajtje, plotësojnë kërkesat e dispozitave ligjore administrative në fuqi

VII. Sanksionet

1. Mosrespektimi i këtij urdhëri nga të punësuarit në Sektorin e Shërbimit Veterinar, Kontrollit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit pranë bashkisë Gramsh, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën veprë penale), kontratën kolektive dhe atë individuale të punës.
2. Sa më sipër, shkelja e këtij urdhëri, sjell si pasojë, vendosjen e sanksioneve Administrative në bazë të parashikimeve në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, akteve të tjera ligjore, nënligjore e normative në fuqi, të cilat janë të pasqyruara edhe në kontratën kolektive e atë individuale të punës.
3. Mosnjohja e këtij urdhëri, nuk e justifikon të punësuarin në Sektorin e Shërbimit Veterinar, Kontrollit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga përgjegjësia disiplinore dhe sanksionet e lartpërmendura.

VIII. Zyra e protokollit arkivit të njoftojë Drejtorin e Drejtorisë Drejtorisë së Shërbimit Pjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe të punësuarit e këtij sektori me këtë urdhër.

IX. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Sektorin e Shërbimit Veterinar, Kontrollit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtori i Drejtorisë Drejtorisë së Shërbimit Pjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYE REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Klodion HAKRI
Kryetar
BASHKIA GRAMSH

Adnan Shahu "Kambar Detyrat" Rruga "10 Korrika" Ad. e cës hekuragrahsh.gov.al E-mail: bashki.gramsh2017@gmail.com



